

URDHËR
Nr. 355, datë 31.12.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të kreut VII, nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm znj. Gelardina Prodani, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fondet buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm nga data 3.1.2019 deri më 31.12.2019.
3. Urdhri nr. 6, datë 10.1.2018, “Për delegim kompetencash” dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCave
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj